LIGJ
Nr.7587, datë 14.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7544, DATË 6.1.1992 "PËR TATIMIN MBI FITIMIN"

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë.29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7544, datë6.1.1992 "Për tatimin mbi fitimin"bëhen këto ndryshime:

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Fitimi i tatueshëm është fitimi vjetor që pasqyrohet në bilancin kontabël. Për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, normat maksimale të amortizimit, si dhe kufijtë e disa shpenzimeve që nuk lidhen me procesin e prodhimit, caktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Fitimi nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë vendas, shtetërorë a privatë, tatohet në masën 30%".

Neni 3

Në nenin 5, fjalët "ndërmarrjeve të përbashkëta" zëvendësohen me fjalët "personave juridikë me kapital të përbashkët".

Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/a me këtë përmbajtje:

"Disa ndërmarrje të industrisë nxjerrëse të mineraleve dhe të naftës, përveç tatimit mbi fitimin në masën 30%, derdhin në buxhet në formë rente edhe shumën e fitimit që rezulton si diferencë ndërmjet kostos individuale, shtuar me një rentabilitet mesatar të degës, dhe çmimi mesatar të shitjes së produktit.

Lista e ndërmarrjeve dhe shuma e fitimit që do të derdhin në buxhet, caktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomise dhe Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare e Energjitike".

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Fitimi nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë me kapital të përbashket, ose plotësisht të huaj, tatohet në masën30%.

Fitimi i personave juridikë me kapital të përbashkët, ose me kapital plotësisht të huaj, që zhvillojnë veprimtari ekonomike 10 vjet të njëpasnjëshëm e lart, përjashtohen nga tatimi për vitet kalendarike 1992, 1993, 1994 dhe 1995, kurse për vitet 1996, 1997 e 1998 u bëhet një zbritje prej 50% të tatimit mbi fitimin. Nuk e përfitojnë këtë lehtësi tatimore personat juridikë të parashikuara në nenin 5/a.

Kur këta persona juridikë gjatë ushtrimit të veprimtarisë prishin kontratën para afatit 10-vjeçar, detyrohen të paguajnë të gjtha lehtësitë tatimore, që kanë përfituar sipas këtij neni deri në atë

moment".

Neni 6

Në nenin 7, në paragrafin e parë, pas fjalëve "nga veprimtaria ekonomike" shtohen fjalët "e personave juridikë".

Neni 7

Në nenin 8, në fjalinë e fundit hiqen fjalët "a fizikë".

Neni 8

Në nenin 9, në fillim të fjalisë së parë hiqen fjalët "e fizikë".

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Personat juridikë, vendas e të huaj, për fitimin e realizuar janë të detyruar të paraqesin në organet tatimore këto deklarata:

- Deklaratën për parashikimin e fitimit që do të realizojnëgjatë vitit.
- Deklaratën periodike 3-mujore për fitimin e realizuar.
- Deklaratën vjetore të fitimit të realizuar, së bashku me bilancin kontabël, sipas statutit të personit juridik.

Deklarata vjetore dhe bilanci kontabël plotësohen sipasmodeleve që përcakton Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dheparaqiten në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Neni 10

Në nenin 11, pas fjalëve "Subjekti juridikë" hiqen fjalët "a fizikë" dhe fjalia e fundit ndryshohet si vijon: "Rillogaritja vjetore për efekt të derdhjes së tatimit bëhet jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së bilancit kontabël".

Neni 11

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Quhen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja e fitimit dhe të ardhurave.
- Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve që përcaktojnë fitimin dhe të ardhurat.
- Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës së fitimit të parashikuar e të realizuar dhe llogarisë vjetore për të ardhurat e shpenzimet.
- Mosrespektimi i afateve të derdhjes së tatimit.
- Raportimi i gabuar i llogarive kontabël mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe të rezultatit ekonomik".

Neni 12

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime e shtesa:

Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

"Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës së fitimit të parashikuar dhe të realizuar dhe e llogarisë vjetore për të ardh- urat e shpenzimet me gjobë nga 6000-8000 lekë".

Në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Raportimi i gabuar i llogarive kontabël mbi të ardhurat, shpenzimet dhe mbi rezultatin ekonomik, me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë".

Neni 13

Në nenin 14, në paragrafin e parë para fjalës "rrethe" shtohen fjalët: "komunë, bashki e...".

Në paragrafin e dytë fjalët "te përgjegjësi i seksionit të financës në rreth zëvendësohen me fjalët "te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Neni 14

Në nenin 15, pas fjalëve "Ministria e Financave" shtohen fjalët "dhe e Ekonomisë".

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.261, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.